



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5. dhe nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (tutje: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), nenit 11 paragrafi 4 dhe 5, si dhe nenit 12 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7. të Rregullores Nr. 03/2023, për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 06.12.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Ekziston konflikti i interesit në rastin APK-DPKI-06-1136/24, për zyrtaren znj. Emine Gllareva, Kryeinxhinierë për Matje, Rregullim dhe Komandim-Korporata Energjetike e Kosovës në Korporatën Energjetike të Kosovës Sh.A., pasi që në cilësinë e anëtares së Komisionit e caktuar sipas Vendimit Nr.4425, i datës 08.07.2024, ka marrë pjesë në vendimmarrje në konflikt të interesit me rastin e vlerësimit të kandidates me nr. të aplikimit 11120 (personi i afërm - vajza e vëllait), sipas Konkursit Nr. 2351, të datës 15.04.2024;
- II. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit kërkon nga Korporata Energjetike e Kosovës:
 - a) shfuqizimin e Kontratës Nr.: 14889/0, datë: 12.09.2024, si dhe aktet tjera juridike që e kanë pasuar atë, përkitazi me kandidaten me Kodin ID 11120, dhe atë konform dispozitave përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit; dhe
 - b) iniciimin e procedurës disiplinore ndaj znj. Emine Gllareva, për shkeljet e dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit,
- III. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, lidhur me dyshimet për veprën penale e procedon rastin në prokurorinë kompetente, konform dispozitave përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit;
- IV. Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative si dhe të njëjtat bëhen publik në faqen zyrtare të Agjencisë.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi për zyrtaren znj. Emine Gllareva, zv. Krye-Inxhinierë për Matje, Rregullim dhe Komandim - Korporata Energjetike e Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka filluar trajtimin e këtij rasti pas pranimi të raportimeve nga jashtë (APK-DPKI-06-1136/24) me pretendimet se (citojmë):

[...] *“Sipas informatave që kam marr një anëtare e komisionit znj. Emine Gllareva ka qenë në komision pranues dhe ka pranuar vajzën e vllaut të vet A.P (e martuar) dhe kushëririn e vet Sh.G. gjë që paraqet konflikt të hapur të interesit sipas ligjit.[...]”*

Në pajtim me nenin 22, paragrafin 3, dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit përmes shkresës zyrtare DPKI-06-1207/24, e ka njoftuar palën për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit.

Me qëllim të sqarimit të plotë dhe të gjithanshëm të këtij rasti, në Agjenci është realizuar një takim me znj. Emine Gllareva, ku janë diskutuar dhe shtjelluar çështjet që kanë të bëjnë me rastin në fjalë. Në takim, znj. Gllareva ka konfirmuar faktin se në cilësinë e anëtares së Komisionit, sipas Konkursit Nr. 2351, të datës 15.04.2024, ka marrë pjesë në vlerësim të kandidatës me Kodin ID 11120, e cila edhe është përzgjedhur si kandidate e suksesshme, si dhe faktin se me të njëjtën kandidate është në lidhje familjare (vajza e vëllait), porse që nuk ka qenë në dijeni se një situatë e tillë përben konflikt të interesit.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, përkritazi me rastin në fjalë, ka kërkuar dokumentacion nga Korporata Energjetike e Kosovës përmes shkresës APK-DPKI-06-1265/24, dhe të njëjtat i ka pranuar përmes postës elektronike. Më pas, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ka kërkuar dhe siguruar dokumentacion shtesë nga Korporata Energjetike e Kosovës në lidhje me konkursin e lartcekur.

Pas shqyrtimit të informacioneve dhe dokumentacionit të bashkangjitur nga raportuesit e rastit, sqarimeve të znj. Emine Gllareva dhënë në takim e mbajtur në Agjenci, dokumentacionit plotësues të siguruar nga Agjencia e Regjistrimit Civil dhe Korporata Energjetike të Kosovës, rezultojnë gjendja faktike si në vijim:

Më kërkesë të Kryeshefit Ekzekutiv të Korporatës Energjetike të Kosovës datë 16.04.2024, nr. 2347, Divizioni i Burimeve Njerëzore, në të njëjtën datë ka publikuar konkursin me titull: *‘Teknik i Elektroenergjetikës’ (149 Pozita, Shkolla e mesme teknike ose elektronike) Nr. 2351;*

Pastaj, më datën 18.04.2024, Korporata Energjetike e Kosovës ka nxjerrë Vendimin Nr. 2397, për formimin e Komisionit Vlerësues për vlerësimin e testimit me shkrim dhe intervistave të kandidatëve për pozitat: Teknik i Elektroenergjetikës dhe Teknik i Elektronikës, ku pjesë përbërëse në cilësi të anëtarit të Komisionit vlerësues është caktuar edhe znj. Emine Gllareva;

Në cilësinë e anëtares së komisionit, znj. Emine Gllareva ka marrë pjesë në vlerësimin e testit me shkrim për kandidaten me Nr. ID 211120, pastaj në shpalljen përfundimtare të rezultateve të testit me shkrim Nr.: 11120, të datës: 15.08.2024, si dhe në procesin e intervistimit (testin) me gojë, për kandidaten e njëjtë, me të cilën është në lidhje familjare (gjinia e gjakut, shkalla e tretë në vijë të tërthortë);

Çështja e afërsisë familjare ndërmjet znj. Emine Gllareva dhe kandidatës së përzgjedhur me Nr. ID 211120, është vërtetuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil, e cila në përgjigjen e saj drejtuar Agjencisë (DPKI-06-1523/24) ka konfirmuar se: *‘bazuar në Regjistrin Qendror të*

Gjendjes Civili, është konstatuar se lidhja e afërsisë familjare ndërmjet znj. Emine Gllareva dhe A.P (kandidates në fjalë - v.j.) është Hallë-Mbesë;

Me datë 12.09.2024, kandidatja me Kodin ID 11120, ka nënshkruar kontratën Nr.: 14889/0, duke themeluar marrëdhënie pune me Korporatën Energjetike të Kosovës, për pozitën 'Teknik i Elektroenergjetikës';

Sa i përket pretendimit të raportuesit të rastit se znj. Emine Gllareva është në afërsi familjare edhe me kandidatin tjetër Sh.G., në përgjigjen e Agjencisë për Regjistrimit Civil sipas kërkesës së Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (e-maila e datës 22.11.2024), konfirmohet se, në bazë të Regjistrimit Qendror të Gjendjes Civile, afërsia familjare e tyre shkon përtej shkallës së katërt në vijë të tërthortë të gjakut, prandaj Sh.G. nuk konsiderohet person i afërt me znj. Emine Gllareva në kuptim të dispozitës përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

I. Andaj, referuar pjesëmarrjes së znj. Emine Gllareva në procesin rekrutues si më sipër, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka konstatuar si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi se, ekziston konflikti i interesit në rastin konkret për zyrtarin znj. Emine Gllareva, pasi që e njëjta në cilësinë anëtares së Komisionit Vlerësues ka marrë pjesë në vendimmarrje në konflikt të interesit duke vendosur për personin e afërm, në kundërshtim me nenin 17, paragrafi 1, lidhur me nenin 6, nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, 1.6 dhe 1.12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku është përcaktuar se:

"Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje",

...lidhur me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përkufizuar se:

"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare."

nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe 1.6. të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilët përkufizohet se:

"interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste"

"person i afërm me zyrtarin – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. Për qëllime të këtij ligji, personi juridik konsiderohet si person i afërm, sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës."

si dhe nën-paragrafin 1.12 të këtij neni, i cili definon nocionin e vendimmarrjes si:

“çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik”.

Pra, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me procesin e **vendimmarrjes**, nën kushtet e ekzistencës së **interesit privat të zyrtarit ose të personave të afërm**, në një çështje të caktuar. Në rastin konkret, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka konstatuar konfliktin e interesit, pasi që janë plotësuar kushtet e sipërpërmendura kumulative, si: **përfshirja në vendimmarrje** në lidhje me **interesin privat të personit të afërm me zyrtarin**.

II. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, kërkon nga Korporata Energjetike e Kosovës shfuqizimin e Kontratës Nr. 14889/0 datë 12.09.2024, përkitazi me kandidatin me Kodin 11120, si dhe akteve tjera juridike që e kanë pasuar të njëjtin, dhe atë konform nenit 22, paragrafi 13, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili përcakton se:

“Agjencia i kërkon rishqyrtimin, revokimin dhe/ose shfuqizimin e aktit të nxjerrë në konflikt të interesit organit që e ka nxjerrë atë. Që nga momenti kur Agjencia kërkon rishqyrtimin e vendimit, çdo veprim për zbatimin e tij pezullohet deri në momentin kur organi vendos për vlefshmërinë e vendimit.”

si dhe nenin 24 paragrafi 5, me të cilin është përcaktuar se: *“Agjencia inicicion procedurën administrative për revokimin ose shfuqizimin e akteve nga ana e institucionit që i ka lëshuar ato në konflikt interesi”.*

Gjithashtu, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit kërkon iniciimin e procedurës disiplinore ndaj znj. Emine Gllareva, për shkeljet e dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, dhe atë sipas nenin 24, paragrafi 1, të këtij ligji, me të cilin është përcaktuar se:

“Çdo shkelje e dispozitave të këtij ligji do të konsiderohet edhe si shkelje disiplinore, pavarësisht përgjegjësive eventuale penale. Shkeljet disiplinore trajtohen në pajtim me rregullat që i rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe statusin e zyrtarëve. Institucionet/organizatat që i kanë iniciuar procedurat disiplinore sipas këtij ligji duhet ta njoftojnë Agjencinë për iniciimin dhe rezultatin e atyre procedurave.”

III. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, lidhur me dyshimet për veprën penale e procedon rastin në prokurorinë kompetente, në pajtim me nenin 24, paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku është përcaktuar se:

“Dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nuk përjashtojnë përgjegjësinë disiplinore dhe penale të zyrtarit sipas legjislacionit në fuqi”, si dhe

“Agjencia, çdo zyrtar, udhëheqës i zyrtarit dhe çdo institucion ushtrojnë kallëzim penal në prokurorinë e shtetit kompetente ndaj zyrtarit i cili shkel detyrimet e parapara me këtë ligj, e që përbëjnë vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës”,

...lidhur me nenin 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, të Ligjit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ku përcaktohet se:

Agjencia është përgjegjëse për: "Referimin e kallëzimeve penale në prokurorinë e shtetit ose në rast të shkeljes administrative përcjelljen e rastit tek organi administrativ kompetent".

VI. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato janë përfundimtare në procedurën administrative, dhe bëhen publike në faqen zyrtare të Agjencisë, konform nenit 22, paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Në kuptim të paragrafit 4 të nenit 19, si dhe paragrafit 1 të nenit 24 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Korporata Energjetike e Kosovës duhet ta njoftoj Agjencinë lidhur me veprimet e ndërmarra në kuptim të pikës II të dispozitivit të këtij vendimi.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit publik (palës)
- Kryeshefit Ekzekutiv të Korporatës Energjetike të Kosovës
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll Buleshkaj
Drejtör i Agjencisë
për Parandalimin e Korrupsionit

